VENDIM
Nr. 661, datë 2.9.2026

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT NGA MINISTRIA PËRGJEGJËSE PËR TURIZMIN TEK MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT, TË NJË PJESE TË PRONËS NR. 284/1, ME VENDNDODHJE NË ZONËN KADASTRALE 3774, VILË BASHTOVË, KAVAJË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 707, DATË 21.11.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË PËRGJEGJËSE PËR TURIZMIN TË DISA PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, NË VIJËN BREGDETARE SHKODËR–FIER", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13 e 15, shkronja "c", të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, dhe të nenit 28, të ligjit nr. 93/2015, "Për turizmin", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga ministria përgjegjëse për turizmin tek Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, të një pjese të pronës nr. 284/1, me sipërfaqe prej 77 358 (shtatëdhjetë e shtatë mijë e treqind e pesëdhjetë e tetë) m^2, me vendndodhje në zonën kadastrale 3774, Vilë Bashtovë, Kavajë, sipas planit të rilevimit, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për realizimin e projekteve ose investimeve me interes publik ose me rëndësi kombëtare që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik të vendit.
2. Në shtojcën, bashkëlidhur vendimit nr. 707, datë 21.11.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për kalimin në përgjegjësi administrimi të ministrisë përgjegjëse për turizmin të disa pronave të paluajtshme shtetërore, në vijën bregdetare Shkodër–Fier", të ndryshuar, në pikën 20, të dhënat e pasurisë nr. 284/1, zona kadastrale 3774, në kolonën "Sip. m² ose ha", zëvendësohen me sipërfaqen 184 092 m².
3. Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit përdor sipërfaqen e pronës, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, vetëm për qëllimin e parashikuar në këtë pikë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për administrimin e pronës shtetërore.
4. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

POSEDUES *REPUBLIKA E SHQIPERISE* DATE 21/08/2026 **QELLIMI** (INVENTARIZIM PASURIE)

VENDNDODHJA : DVASHK/ZVASHK: KAVAJE ZONA KADASTRALE: 3774 NUMRI PASURISE: 284/1

BASHKIA : RROGOZHINE FSHATI : *VILE-BALLAJ* INDEKS HARTE:K-34-100- (223-A,C) VOL 10 FQ 22

TE DHENAT E PASURISE

LLOJI PASURISE ---------- SIP PASURISE – *261458* m² NUMRI KATEVE ____ NUMRI PEMBVE ____

SIPERFAQE GJURMES NDERTIMIT – __ m²

1-X=452804.8095 Y=4545838.7714

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

2-X=454295.9728 Y=4545838.7714

284/1/B

284/1/A

284/1/C

SH 1 : 2500

4-X=452904.8095 Y=4543544.0836

3-X=454295.9728 Y=4543544.0836

SHPJEGUES

PER NDARJE PASURIE

$S_{284/1/A}$ = 77 358 m²

$S_{284/1/B}$ = 23 800 m²

$S_{284/1/C}$ = 160 292 m²

Nr.	ORIENTIMI	PERSHKRIMI	PIKAT E VIJUESE	KUFIJTARI	SHENJTE	SHENIME TE REALIZUESIT
1	VERI					
2	LINDJE		—	—		
3	JUG					
4	PERENDIM		—	—		

Fatos Abenati

TEKNOLOGJIA E MATJENIT: G.T

PERGATITI I GJIRIT P.P

SHENIME TE VEGJATA:

KONFIRMOI